



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 111, Datë 14.05.2018**

**MBI**

**MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË OSHEE SH.A. PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE QË KA NËNSHKRUAR KJO SHOQËRI ME SHOQËRINË E LICENCUAR NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE "GRID ENERGY" SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 15 të “Rregullave të Organizimit, Funkionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe nenit 20.1 të “Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet “OSHEE” sh.a. dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.02.2017, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.05.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në lidhje me shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës së shoqërisë OSHEE sh.a. për miratimin e marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike që ka nënshkruar kjo shoqëri me shoqërinë e licencuar në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike " Grid Energy" sh.p.k.

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “OSHEE” sh.a. me shkresën nr. 7748 Prot., datë 27.04.2018 ka dërguar në ERE marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike nr. 6730 Prot, datë 13.04.2018 dhe nr. 08 Prot, datë 13.04.2018 nënshkruar midis "OSHEE" sh.a. dhe " Grid Energy" sh.p.k me qëllim miratimin nga ERE.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 96 datë 27.10.2014, ka vendosur për licencimin e shoqërisë OSHEE sh.a në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për një afat 30 vjeçar.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 48, datë 31.3.2017 është shprehur mbi licencimin e shoqërisë "Grid Energy" sh.p.k, në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar)

- Bordi i ERE me vendimin nr. 24, datë 15.02.2017, ka miratuar “Marveshjen e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet “OSHEE” sh.a. dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike”.
- Në nenin 20.1 të “Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet “OSHEE” sh.a. dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike” sanksionohet se: “*Kjo Marrëveshje hartohet në 5 kopje origjinale, në gjuhën Shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore, 2 për secilën Palë dhe 1 për t’u dërguar për miratim në ERE*”.
- Në përmbajtjen e saj, kjo marrëveshje e nënshkuar dhe dakortësuar mes palëve ka reflektuar saktësisht të gjitha dispozitat që ERE ka parashikuar në marrëveshjen tip të cilën e ka miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 24, datë 15.02.2017.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE :

**Vendosi:**

1. Të miratojë e kërkesën e shoqërisë “OSHEE” sh.a. për miratimin e marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike nr. 6730 Prot, datë 13.04.2018 dhe nr. 08 Prot, datë 13.04.2018 nënshkruar midis "OSHEE" sh.a. dhe "Grid Energy" sh.p.k.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**PETRIT AHMETI**